



## SYLLABUS I LËNDËS “MBROJTJA NDËRKOMBËTARE E TË DREJTAVE TË NJËRIUT”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njëriut
Programi:	Juridik i Përgjithshëm
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	14:00 - 16:15
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. asoc. dr. Halim Bajraktari
Të dhënat kontaktuese:	halim.bajraktari@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	<p>Mbrojtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njëriut, u ofron studentve njohuri bazike lidhur me: njohuri të përgjithshme të konceptit të të drejtave të njëriut; historikun e të drejtave të njëriut; sistemin Universal, veçanërisht sistemin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njëriut, po ashtu dhe disa sisteme regjionale. Një fokus i rëndësishëm do t'i kushtohet Sistemit European për të drejtat e njëriut, me theks të posaçshë rolin dhe funksionet e Këshillit të Europës, përkatësisht Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njëriut.</p> <p>Po ashtu, në këtë lëndë do të trajtohen tema si: roli i të drejtave të njëriut në aspektin kombëtar e ndërkombëtar. E Drejta e popujve për vetëvendosje; Roli i Organizatave Ndërkombëtare Jo-Qeveritare në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njëriut; Aparteidi; Mbrojtja e të drejtave të njëriut në konflikte të armatosura; Gjenocidi; Mbrojtja ndërkombëtare e Refugjatëve dhe e drejta e azilit. Gjithashtu domosdoshmërisht në këtë planëprogram përfshihet dhe mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njëriut në republikën e Kosovës, e rajon.</p> <p>.</p>
Qëllimi i lëndës:	Lënda ka për qëllim primar, që studentit t'i ofrojë njohuritë e adresime të nevojshme lidhur mbrojtje ndërkombëtare

	<p>për të drejtat e njëriut, strukturën ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njëriut, si dhe mekanizmat për mbrojtjen e këtyre të drejtave në përgjithësi dhe lidhur me këto të drejta në Kosovë në veçanti, njëherit duke përfshirë një analizë kritike lidhur me strukturën institucionale dhe zbatuese, që paraqesin një interes thelbësor lidhur me lëndën.</p> <p>Qëllim i kësaj lënde është që të bëjë një analizë lidhur me shqyrtimin e dispozitave ligjore, rasteve praktike dhe masat që duhen të ndërmerren lidhur me shkeljen e të drejtave të njëriut, dhe mbrojtjen e tyre si në sistemin vendor, rajonal po ashtu edhe në sistemin ndërkombëtar. Gjithashtu do t'i kushtohet rëndësi edhe sistemit kushtetues dhe ligjor të mbrojtjes së të drejtave të njëriut në Kosovë.</p> <p>Përfundimisht, kjo lëndë ka për qëllim që të ofrojë njohuri thelbësore lidhur me të drejtat e njëriut, strukturën institucionale të sistemit nërkombëtar, atij rajonal dhe sistemit vendor lidhur me mbrojtjen e të drejtave të njëriut, duke analizuar dhe studiuar raste praktike gjyqësore për mbrojtjen e të drejtave të njëriut.</p>
<p><b>Rezultatet e të nxënit:</b></p>	<p>Studenti pritet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Të kuptojë zhvillimin dhe diskursin e të drejtave të njëriut;</li> <li>-Të idefinojë standartet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njëriut;</li> <li>-Të identifikojë burimet universal, regjionale dhe vendore për mbrojtjen e të drejtave të njëriut;</li> <li>-Të kuptojë dhe shpjegojë sistemet europian për të drejtat e njëriut;</li> <li>-Të njohë procedurat për mbrojtjen e të drejtave të njëriut, si në nivelin rajonal ashtu edhe në nivelin ndërkombëtar;</li> <li>-Të kuptojë dhe njohin të drejtat specifike, si shembull: mbrojtja e pakicave, e drejta e vetëvendosjes, ndalimi i diskriminimit, refugjat, azilit etj;</li> </ul>

	<p>-Të identifikojë obligimet e shteteve lidhur me të drejtat dhe liritë e njeriut dhe të interpretojë aplikushmërinë e tyre në Kosovë,</p> <p>-Të respektojë këto të drejta duke i çmuar dhe respektuar si brenda vendit dhe në arenën ndërkombëtare,</p> <p>-Të forcojë horizontin lidhur me këtë fushë detyrime e zbatimesh që kanë institucionet vendore dhe ato ndërkombëtare për ti çmuar sa më shumë këto të drejta.</p>		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike	1	15	15
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	10	10
Ushtrime në terren	2	6	6
Kollokfiume, seminare	1-2	3-6	6
Detyra të shtëpisë	1	5	5
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitja përfundimtare për provim	1	6	6
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	1	15	30
Projektet, prezantimet ,etj	1	10	10
<b>Totali</b>			<b>175 Orë (7 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Metodologjia e ligjërimit do të orientohet në krijimin e mundësive te studentët për të zotëruar dhe fituar njohuritë për të drejtat e njeriut. Do të inkurajohen studentët që të marrin pjesë në mënyrë aktive në ligjërata, ushtrime dhe përmes prezantimeve të eseve ose punimeve seminarike nga fusha e kësaj të drejte. Ligjërata do të prezantohet sipas metodës interaktive.</p> <p>Gjatë ligjërimit të lëndës po ashtu, do të përdoren metodat bashkëkohore të mësimdhënies, me efekt që kjo disiplinë e</p>		

	<p>së drejtës të bëhet më e kapshme, më e qartë dhe më e lehtë për t'u mësuar dhe zbatuar. Ndërsa ushtrimet do të trajtohen temat nga kjo lëndë nëpërmjet interaktivitetit dhe angazhimit të studentëve në dhënien e mendimeve kritike; trajtohen shembuj dhe raste të ndryshme praktike lidhur me zgjidhjen e problemeve ku atakohen këto shkelje të të drejtave në ditet e sotme.</p>
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	<p>Kollokfiumi llogaritet i sukseshumë nëse studenti i arrinë 51% të pikëve të mundëshme (100).</p> <p>-Provimi llogaritet i sukseshumë nëse studenti i arrinë 51% të pikëve të mundëshme (100).</p> <p>-Çdo student duhet t'i nënshtrohet provimit!</p> <p>-Nëse nota e kollokfiumit të sukseshëm është më e lartë se ajo e provimit të sukseshumë, atëher do të nxirret nota mesatare si notë përfundimtare.</p> <p>Në të gjitha rastet tjera vlenë vetëm nota e provimit.</p> <p>Pjesëmarrja dhe angazhimi në mësim prezente te punimeve do të vlersohet me 10% të pikëve të mundëshme (100)</p>
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura primare:</b>	<p>-E Drejta Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Gentian ZYBERI dhe Qerim QERIMI, botimi i dytë, Shkurt, 2015.</p> <p>-Mbrotjtja Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, Zejnullah Gruda, Botim i pestë, Prishtinë 2010.</p>
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>- Remzije Istrefi / Iliriana Islami / Qerim Qerimi, <i>Të Drejtat e Njeriut sipas Jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut</i>- Përmbledhje të Rasteve, publikuar nga: Akademia e Drejtësisë së Kosovës 2018.</p> <p>- Walter Kalin &amp; Jorg Kunzli, <i>The Law of International Humanitarian Rights Protection</i>, Oxford, 2009.</p> <p>-Jordan Daci, <i>Të drejtat e njeriut</i>, Tiranë 2011.</p> <p>-Peter Halstead, <i>Human Rights, key facts key cases</i>. Oxford.</p>

	<p>-Përmbledhje e marrëveshjeve dhe instrumentave ligjore nderkombëtare, Prishtinë 2016.</p> <p>-Të drejtat e njeriut, <i>Përmbledhje instrumentash ndërkombëtar</i>, vëllimi II instrumente rajonale.</p> <p>-Raija Hanski &amp; markku Suksi, <i>Hyrje në mbrojtjen nderkombëtare të të drejtave të njeriut</i>, <i>Instituti për të drejtat e njeriut Turko ABO 1999</i>.</p> <p>- <i>Jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut</i>, Ledi Binaku, Qendra Evropiane, Kishilli i Evropës &amp; Këshilli Evropian, Tiranë, 2005.</p> <p>-Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.</p> <p>-Kushtetuta e Kosovës. ligjet, vendore, rajonale e nderkombëtare, konventat e ndryshme, rezolutat, pakten, deklarata universal e drejtave të njeriut e vitit 1948.</p>
--	---

Plani i dizajnuar i mësimi:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
Java e parë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Njohje e përgjithëshme me metodologjinë e punës,</li> <li>- Hyrje në të drejten ndërkombëtare të mbrojtjes të drejtave dhe lirive të njeriut</li> <li>- Origjina dhe kuptimi i të drejtave të njeriut, nocionet.</li> </ul>	<p>Hyrje</p> <p>Prezantim për metodologjinë mbajtjes së ushtrimeve;</p> <p>Metodat e vlerësimit në ushtrime</p>
Java e dytë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillimi historik, paraqitja e të drejtave të njeriut.</li> <li>- Burimet e të Drejtës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.</li> </ul>	<p>Lindja dhe zhvillimi historik i mbrojtjes së të drejtave të njeriut.</p> <p>Burimet.</p>

Java e tretë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Nocioni të drejtat dhe liritë e njeriut, sistemi universal i mbrojtjes të drejtave dhe lirive të njeriut,</li> <li>- Karta e OKB-së dhe të drejtat e njeriut,</li> <li>- Mekanizmat dhe organet e OKB-së për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut.</li> </ul>	<p>Sistemi Universita dhe të drejtat e njeriut.</p> <p>Mekanizmat e OKB- së për të drejtat e njeriut dhe roli ityre në raste të cauktuar.</p>
Java e katërt:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Këshilli i Asamblesë të OKB-së për të drejtat e njeriut.</li> <li>- Deklarata Universale për të drejtat e njeriu,</li> <li>- Paktet mbi të drejtat e njeriut, mekanizmat për implementimin e pakteve.</li> </ul>	<p>Raste studimi nga praktika e Komitetit për të drejtat e njeriut.</p> <p>Puan në grupe me studentët.</p>
Java e pestë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sistemi European për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut,</li> <li>- Këshilli i Europës,</li> <li>- Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut.</li> <li>- Bashkimi European dhe të Drejtat e Njeriut.</li> </ul>	<p>Konventa Evropiane për të drejtat e njeriut.</p> <p>Prezetime nga studentët për të drejtat e mbrojtura me Konventë.</p>
Java e gjashtë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjykata Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave</li> </ul>	<p>Raste studimi nga praktika gjyqësore nga GJEDNJ.</p>

	<p>dhe Lirive të Njeriut; juridiksioni dhe mjetet juridike.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Procedura para Gjykatës.</li> </ul>	Puna me grupe të vogla me studentët
Java e shtatë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sistemet tjera (Organizatata regjionale si: Unioni Afrikan, Liga Arabe dhe Organizata e shteteve të Amerikës) për mbrojtje e të drejtave të njeriut.</li> </ul>	Hulumtimi dhe prezentimi nga studentët Organizata regjionale për të drejtat e njeriut
Java e tetë:	<b>Kollokfiun/Test/Ustrim/Casus</b>	
Java e nëntë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- E Drejta e Popujve për Vetëvendosje.</li> <li>- Roli i OJQ-ve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut,</li> <li>- OJQ-të në Kosovë.</li> </ul>	<p>Raste e shteteve të drejtën e popujve për vetëvendosje</p> <p>Kosova dhe e drejta e vetëvendosjes.</p>
Java e dhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Parimi i ndalimit të diskriminimit,</li> <li>- Normat dhe mekanizmat ndërkombëtar për ndalimin e diskriminimit,</li> <li>- Institucionet ndërkombëtare të specializuara për luftimin e diskriminimit.</li> <li>- Aparteidi.</li> </ul>	<p>Punë hulumtuese dhe prezentim nga studentët.</p> <p>Diskusime për diskriminimin</p> <p>Trajtimi i aparteidit në Afrikën e Jugut</p>

Java e njëmbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbrojtja e të drejtave të njeriut në konfliktet të armatosura,</li> <li>- Konventat e Gjenevës dhe Protokolet e saj.</li> </ul>	<p>Puna hulumtuese dhe prezentimi i studentëve për Konventat e Gjenevës.</p> <p>Raste gjyqësore të Tribunalëve Ndërkombëtare.</p>
Java e dymbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjenocidi, nocioni, historiku i tij,</li> <li>- Konventa mbi parandalimin e gjenocidit, përgjegjësitë ndërkombëtare penalo-juridike,</li> <li>- Gjykata e Përhershme Penale Ndërkombëtare.</li> </ul>	<p>Raste studimi të gjenocidit nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë dhe Gjykatat Penale Ndërkombëtare.</p>
Java e trembëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbrojtja ndërkombëtare e refugjatëve,</li> <li>- Aktet ndërkombëtare mbi trajtimin e refugjatëve, masat humanitare për refugjatë,</li> <li>- E drejta e azilit,</li> <li>- Këshilli për të drejtat e njeriut.</li> </ul>	<p>Raste reale të refugjatëve dhe mbrojtja juridike e tyre.</p> <p>Raste dhe shembuj të të drejtës së azilit dhe mbrojtja juridike e tyre.</p>
Java e katërbëdhjetë:	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbrojtja e të drejtave të njeriut në Kosovë, hirarkia normative, aplikushmëria e drejtpërdrejtë e normave ndërkombëtare në Kosovë,</li> <li>- Avokati i Popullit dhe roli i tij,</li> </ul>	<p>Shqyrtimi i mekanizmave dhe legjislacionit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Kosovë</p> <p>Punë me grupe me studentët.</p>





	- Mbrojtja e pakicave nacionale.	
Java e pesëmbëdhjetë:	- <i>Debate rreth lëndës, diskutime, praktikim, këshilla dhe rekomandime, debate për përgaditjen e provimit përfundimtar.</i>	

#### **Politikat akademike dhe kodi i sjelljes**

- Studentet duhet të kenë vijueshmëri të rregullt në ligjërata dhe ushtrime, ku vijueshmëria do të evidentohet nëpërmjet listës së prezencës të studentëve (në ligjërata dhe ushtrime).
- Pjesëmarrja e rregullt në ligjërata dhe ushtrime, prezentimi i punimeve seminarike dhe aktivitete të tjera do të llogariten në notën përfundimtare.
- Në ligjërata dhe ushtrime të të trajtohen vetëm temat e parapara me këtë planprogram.
- *Komunikimi* me studentët do të bëhet kryesisht përmes e-mailit zyrtar dhe shpalljeve në lokalet e universitetit si dhe gjatë orarit zyrtar të konsultimeve.